



FEDERATA
SHQIPTARE E
FUTBOLLIT

RREGULLORE E LIÇENSIMIT

të Klubeve për Pjesëmarrje në
Veprimtaritë e FSHF-së

2018





Federata Shqiptare e Futbollit

Rregullore e licensimit të klubeve për pjesëmarrje në kompeticionet kombëtare të FSHF-së

Botim zyrtar, 2018

Rregullore e licensimit të klubeve për pjesëmarrje
në kompeticionet kombëtare të FSHF-së

Botimi u përgatit nga Drejtoria Juridike dhe Licensimit të FSHF-së.
Aprovuar nga Komiteti Ekzekutiv i FSHF-së më 08.11.2018.

Federata Shqiptare e Futbollit

President:

Armand DUKA

Sekretari Përgjithshëm:

Ilir SHULKU

Themeluar: 1930

Anëtare në UEFA: 1954

Anëtare në FIFA: 1930

Realizoi botimin: “Reklama”

PËRMBAJTJE

I. Dispozita të përgjithshme	6
Neni 1 – Qëllimi i aplikimit	6
Neni 2 – Objektivat	6
Neni 3 – Kriteret e licensimit	7
II. Licensuesi	8
Neni 4 – Përgjegjësitë	8
Neni 5 – Administrata e licensimit	8
Neni 6 – Komisionet vendimmarrëse	9
Neni 7 – Katalogu i sanksioneve	12
Neni 8 – Procesi themelor	12
Neni 9 – Procedurat e vlerësimit	13
Neni 10 – Trajtimi i barabartë dhe ruajtja e sekretit	13
III. Aplikanti për licensë dhe Licensa	14
Neni 11 – Përcaktimi i aplikantit për licensë	14
Neni 12 – Përgjegjësitë e aplikantit për licensë	14
Neni 13 – Licensa	14
Neni 14 – Leje të veçanta për pjesëmarrje në kompeticionet e FSHF-së	15

IV. Dispozita përfundimtare	16
Neni 15 – Anekset	16
Neni 16 – Kontrolli i përputhjes së auditimit	16
Neni 17 – Zbatimi i dispozitave	16
Neni 18 – Përshtatja, shfuqizimi dhe hyrja në fuqi	16
Aneks I: Procesi themelor dhe kriteret e licensimit	17
A – Procesi	17
B – Kriteret e licensimit	20
Aneks II: Aplikime të jashtëzakonshme të sistemit të licensimit të klubeve	38
Aneks III: Përcaktimi i audituesit dhe procedurat vlerësuese të audituesit	39
A – Të përgjithshme	39
B – Procedurat e vlerësimit	39
Aneks IV: Kërkesat minimale sqaruese	41
A – Të përgjithshme	41
B – Bilanci	41
C – Përfitimet dhe humbjet	44
D – Deklarata e parave rrjedhëse	45
E – Shënimet e deklaratës financiare	46
F – Shqyrtimi financiar nga drejtuesit	48

Aneks V: Bazat për të përpiluar një deklaratë financiare	49
A – Të përgjithshme	49
B – Vlerësimi i raportit të audituesit në deklaratat financiare vjetore	50
Aneks VI: Nocioni i “pagesave të vonuara”	51
Aneks VII: Procedurat e vlerësimit të FSHF-së	52
A – Të përgjithshme	52
B – Vlerësimi i raportit të audituesit në deklaratat financiare vjetore	52
C – Vlerësimi i pagesave të vonuara kundrejt klubeve të tjera	53
D – Vlerësimi i pagesave të vonuara kundrejt punonjësve dhe autoriteteve sociale dhe të taksave	55
E – Vlerësimi i letrës së prezantimit me shkrim	56
F – Vlerësimi për informacionin financiar të së ardhmes ..	57
Aneks VIII: Tabela e pagesave për transfertat	58

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi i aplikimit

Këto rregulla përcaktojnë kriteret e licensimit që klubet duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në të gjitha kompeticionet apo veprimtaritë futbolistike që luhen nën siglën e FSHF-së (këtej e tutje: kompeticionet e FSHF-së).

Neni 2 Objektivat

Sistemi i FSHF-së për licensimin e klubeve ka objektivat e mëposhtëm:

- a) Ngritjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve në të gjitha aspektet e futbollit në Shqipëri, si dhe vendosjen si prioritet të vazhdueshëm trajnimin dhe përkujdesjen për talentet e reja të klubeve;
- b) Sigurimin që një klub të ketë një nivel të përshtatshëm menaxhimi dhe organizimi;
- c) Përshtatjen e infrastrukturës sportive të klubeve për t'u siguruar lojtarëve, spektatorëve dhe përfaqësuesve të mediave kushte të mira dhe të sigurta;
- d) Përmirësimin e kapaciteteve ekonomike dhe financiare të klubeve, rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së tyre, si dhe vënien e theksit në mbrojtjen e kreditorëve;
- e) Ruajtjen e vazhdimësisë së kompeticioneve kombëtare për një sezon;
- f) Monitorimin e respektimit të rregullave financiare në kompeticione;
- g) Pranimin e zhvillimit të praktikave krahasuese ndërmjet klubeve në lidhje me kriteret financiare, sportive, ligjore, administrative dhe infrastrukturore kudo në Shqipëri.

Neni 3 Kriteret e licensimit

1. Kriteret e përcaktuara në këtë rregullore (Aneksi IB) duhet të përmbushen nga klubet, në mënyrë që të sigurohet një licensë për të hyrë në kompeticionet e organizuara nga FSHF.

2. Kriteret e licensimit janë:
 - 1. Kriteret sportive,**
 - 2. Kriteret e infrastrukturës,**
 - 3. Kriteret administrative dhe personelit,**
 - 4. Kriteret ligjore**
 - 5. Kriteret financiare.**

3. Kriteret ndahen përsëri në tri shkallë të ndryshme: „A“, „B“ dhe „C“.
 - a) Kriteret „A“ janë të detyrueshme. Nëse aplikanti për licensë nuk i plotëson kriteret „A“, atëherë atij nuk mund t’i jepet licensa për të hyrë në kompeticionet e organizuara nga FSHF.
 - b) Kriteret „B“ janë të detyrueshme. Nëse aplikanti për licensë nuk plotëson kriteret „B“, atëherë ai sanksionohet, siç specifikohet nga licensuesi, por mund të marrë një licensë për të hyrë në kompeticionet e organizuara nga FSHF.
 - c) Kriteri „C“ janë rekomandimet për praktikat më të mira. Mosplotësimi i ndonjë kriteri C nuk çon në ndonjë sanksion ose në refuzim license. Kriteret „C“ të caktuara mund të bëhen “domosdoshmëri” në një stad të mëvonshëm.

4. Çdo mosplotësim i detyrimeve të përcaktuara në këtë Rregullore (p.sh. mosrespektimi i afateve të vendosura për paraqitjen e informacionit të kërkuar, dokumentacion i falsifikuar, veprime jo të ligjshme gjatë procedurave të licensimit do të paraqiten në Komisionin e Disiplinës, i cili vendos për sanksionet e mëtejshme bazuar në Rregulloren e Disiplinës të FSHF-së.

II. LICENSUESI

Neni 4 Përgjegjësitë

1. Licensuesi është Federata Shqiptare e Futbollit (FSHF), e cila drejton sistemin e licensimit të klubeve.
2. Veçanërisht, FSHF-ja duhet:
 - a) të ngrejë një administratë të përshtatshme, siç është përcaktuar në Nenin 5;
 - b) të ngrejë të paktën dy borde vendimmarrëse, siç është përcaktuar në Nenin 6;
 - c) të përpilojë një listë sanksionesh, siç është përcaktuar në Nenin 7;
 - d) të përcaktojë procesin themelor, siç është përcaktuar në Nenin 8;
 - e) të vlerësojë dokumentacionin e dorëzuar nga klubet, të gjykojë nëse është i përshtatshëm dhe të përcaktojë nëse çdo kriter është përmbushur dhe çfarë informacioni i mëtejshëm nevojitet, siç është përcaktuar në Nenin 9;
 - f) të sigurojë trajtim të njëjtë mes gjithë klubeve që aplikojnë për licensë dhe t'u garantojë klubeve fshehtësi të plotë për të gjithë informacionin e dorëzuar gjatë procesit të aplikimit, siç është përcaktuar në Nenin 10;
 - g) të përcaktojë nëse një licensë është e vlefshme.

Neni 5 Administrata e licensimit

1. Detyrimet e administratës të licensimit duhet të përfshijnë:
 - a) përgatitjen, zbatimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të licensimit të klubeve;
 - b) sigurimin e mbështetjes administrative për trupin vendimmarrës;
 - c) asistimin, këshillimin dhe monitorimin e të licensuarve gjatë sezonit;

- d) shërbimin si një pikë kontakti për dhënien e ekspertizës nga departamentet e tjera të licensimit të shoqatave të tjera anëtare të FSHF-së, si dhe nga vetë FSHF-ja.
2. Administrata e Licensimit duhet të përbëhet nga staf i kualifikuar dhe të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.
 3. Administrata e Licensimit do të drejtohet nga Menaxheri i Licensimit dhe departamenti do të angazhojë një numër ekspertësh përgjegjës për çdo lloj kriteri specifik
 4. Të paktën njëri anëtar i stafit apo një këshilltar finance i jashtëm duhet të ketë një kualifikim dhe diplomë në ekonomi/financë të njohur në shkallë kombëtare apo të ketë eksperiencë disa vjeçare në fushat e lartpërmendura.
 5. Të gjithë personat e përfshirë në procesin e licensimit duhet të plotësojnë rregullat e konfidencialitetit në lidhje me informacionin e marrë në procedurat e licensimit.

Neni 6 – Komisionet vendimmarrëse

1. Komisionet vendimmarrëse janë Komisioni i Shkallës së Parë dhe Komisioni i Apelit, të cilat duhet të jenë të pavarura nga njëri-tjetri.
2. Komisioni i Shkallës së Parë vendos nëse një licensë duhet t'i jepet një aplikanti në bazë të dokumentacionit të paraqitur brenda afatit të vendosur nga FSHF-ja dhe nëse një licensë duhet tërhequr.
3. Komisioni i Apelit vendos për apelet e dorëzuara me shkrim dhe merr një vendim përfundimtar nëse një licensë duhet të jepet.
4. Apelet mund të depozitohen vetëm nga:
 - a) Aplikanti për licensë, i cili ka marrë refuzimin nga Komisioni i Shkallës së Parë;
 - b) I licensuari, licensa e të cilit është tërhequr nga Komisioni i Shkallës së Parë;
 - c) Menaxheri i Licensimeve i FSHF-së.
5. Komisioni i Apelit merr vendimet bazuar në vendimet e Komisionit të Shkallës së Parë dhe të gjithë provat e siguruar nga aplikantët për licensë ose FSHF-ja, bashkë me kërkesat me shkrim për apel brenda

afatit të përcaktuar në procedurat e Apelit, të përshkruara në par. 10 të Nenit 6.

6. Anëtarët e komisionit vendimmarrës janë emëruar nga Komiteti Ekzekutiv i FSHF-së për një periudhë katër vjeçare dhe duhet:
 - a) të veprojnë në mënyrë të paanshme në kryerjen e detyrës së tyre;
 - b) të abstenojnë nëse ka ndonjë dyshim rreth pavarësisë së tyre nga aplikanti për licensë apo nëse ka një konflikt interesi. Kështu, pavarësia e anëtarit nuk është e garantuar nëse ai/ajo apo çdo pjesëtar i familjes së tij/saj (bashkëshort, fëmijë, prind, vëlla/motër) është anëtar, aksioner, partner biznesi, sponsorizues apo konsulent i aplikantit për licensë. Lista e mësipërme është ilustruese dhe jo gjithëpërfshirëse.
 - c) të mos kryejnë njëkohësisht detyrën e Menaxherit të Licensimit;
 - d) të mos i përkasin njëkohësisht asnjë trupi statutor apo organ tjetër të FSHF-së, siç është specifikuar në Nenin 40, par.1 të statutit të FSHF-së.
7. Komisionet vendimmarrëse duhet të kenë si anëtar të tyre të paktën dy juristë dhe dy auditues të kualifikuar nga institucionet kombëtare,
8. Anëtarët e Komisionit të Apelit duhet të mos i përkasin njëkohësisht as stafit administrativ apo çdo trupi tjetër statutor apo komiteti të FSHF-së.
9. Kuorumi i organeve vendimmarrëse duhet të jetë të paktën tre anëtarë. Kryetari ka votën vendimtare në rastin kur numri i votave është i barabartë.
10. Komisionet vendimmarrëse duhet të operojnë sipas rregullave proceduriale, të cilat si minimum duhet të përcaktojnë standardet e mëposhtme:
 - a) Afatet e fundit
Afatet e fundit të të gjithë procesit të licensimit janë përcaktuar në një tabelë të veçantë, e cila është përpunuar nga Administrata e Licensimit dhe u është komunikuar aplikantëve për licensë bashkë me paketën e informacioneve të tjera (formulari i aplikimit etj.) brenda 31 dhjetorit të çdo viti.

- b) Ruajtjen e parimeve për trajtim të barabartë.
Të drejtat themelore procedurale u garantohen palëve, veçanërisht e drejta për trajtim të barabartë si dhe e drejta për t'u dëgjuar (përfshirë të drejtën e fjalës, të drejtën për nxjerrjen e provave si dhe të drejtën për të marrë pjesë në nxjerrjen e këtyre provave.)
- c) Përfaqësimin
Të gjitha klubet kanë të drejtën të përfaqësohen ligjërisht në takimet e Komisionit të Shkallës së Parë dhe Apelit. Përfaqësuesi i aplikantit për licensë duhet të jetë i autorizuar nga klubi.
- d) Të drejtën për t'u dëgjuar
Të gjithë klubet kanë të drejtën për t'u dëgjuar nga Komisioni i Shkallës së Parë dhe Apelit.
- e) Gjuha zyrtare
Gjuha zyrtare që duhet përdorur në procedura do të jetë *shqip* ose *anglisht*. Komisionet dhe palët mund të zgjedhin njëren nga këto gjuhë. FSHF-ja mundet, nëse është e nevojshme, të përdorë një përkthyes.
- f) Afatet kohore për të përpunuar një kërkesë
Afatet kohore që një aplikant license duhet t'i përgjigjet një kërkesë të FSHF-së për informacion shtesë është 3 (tri) ditë punë që nga data e marrjes së kërkesës.
- g) Afatet kohore të apelit
Një aplikant mund të depozitojë një kërkesë për apel duke i dhënë një njoftim 5 (pesë) ditë pune pas datës së dhënies së vendimit të Komisionit të Shkallës së Parë.
- h) Rezultatet e Apelit
Apeli nuk mund të ketë rezultate të vonuara
- i) Provat
Prova shtesë mund të nxirren para Komisionit të Apelit nga apeluesi, nëse kjo kërkohet nga FSHF.
- j) Detyrimi për argumentim
Aplikanti për licensë ka detyrimin të paraqesë argumente

- k) Vendimi
Vendimi duhet të jetë në formën e shkruar bashkë me argumentet përkatës.
- l) Vend për ankesa.
Ankesat duhet t'i dorëzohen FSHF-së. Kjo e fundit duhet të shqyrtojë ankesat dhe të vendosë nëse janë të justifikueshme.
- m) Përmbajtja dhe forma e mbrojtjes
Mbrojtja duhet të dorëzohet në formë të shkruar dhe duhet të ketë baza të apelit dhe mbrojtjes.
- n) Diskutimet/Shqyrtime
Diskutimet bëhen në fshehtësi.
- o) Kostot e procedurave/ taksa administrative/ depozita
Klubit nuk do t'i ngarkohet asnjë kosto për të gjithë procedurën.

Neni 7 Katalogu i sanksioneve

1. Në rast se aplikanti për licensën e FSHF-së apo i licensuari nuk plotësojnë ndonjë kriter referuar në Nenin 3 (par.3/b) organi kompetent disiplinor i FSHF-së do të vendosë sanksion (apo kombinim sanksionesh) në përputhje me katalogun e sanksioneve të përcaktuara në Nenin 44 par. 1 dhe 4 të Statutit të FSHF-së.
2. Të gjitha dhunimet e tjera të kësaj Rregullore do të penalizohen nga organi kompetent disiplinor i FSHF-së në përputhje me Rregulloret Disiplinore të saj.

Neni 8 Procesi themelor

1. FSHF-ja ka përcaktuar procesin themelor (shih Aneksin I) mbi kriteret që duhet të plotësohen, verifikimin e tyre si dhe të kontrollojë lëshimin e licensave.
2. Kalendaritë përpilohet dhe u shpërndahet klubeve dhe të gjithë palëve të përfshira në Sistemin e Licensimit për pjesëmarrje në kompeticionet e FSHF-së në fund të dhjetorit të çdo viti.

Neni 9 Procedurat e vlerësimit

Metodat e vlerësimit janë përcaktuar nga FSHF-ja, përveç atyre të cilat përdoren për të verifikuar përputhjen e kriterëve financiarë, për të cilat procedurat specifike të vlerësimit që duhen ndjekur janë përcaktuar në Aneksin VII.

Neni 10 Trajtim i barabartë dhe ruajtja e fshehtësisë

1. FSHF-ja duhet të sigurojë trajtim të barabartë për të gjithë aplikantët për licensë gjatë procesit themelor.
2. FSHF-ja duhet t'u garantojë aplikantëve për licensë fshehtësi të plotë për të gjithë informacionin e dorëzuar gjatë procesit të licensimit.

III. APLIKANTI PËR LICENSËN E FSHF-së DHE LICENSA E FSHF-së

Neni 11 Përcaktimi i aplikantit për licensë

Aplikant për licensë mund të jetë vetëm një klub futbollit, p.sh: një strukturë ligjore plotësisht e përgjegjshme, që të marrë pjesë në një nga kompeticionet kombëtare dhe ndërkombëtare, anëtar i regjistruar në FSHF.

Neni 12 Përgjegjësitë e aplikantit për licensë

1. Aplikanti për licensë duhet t'i dorëzojë FSHF-së:
 - a) të gjithë informacionin e nevojshëm dhe/ose dokumente që vërtetojnë se detyrimet e licensës janë përmbushur; dhe
 - b) çdo dokument tjetër të vlefshëm për vendimmarrjen e FSHF-së.
2. Këtu përfshihen informacione mbi strukturën/strukturat raportuese lidhur me informacionin sportiv, infrastrukturor, të personelit, administratës, ligjor dhe financiar që duhen dorëzuar.
3. Çdo eveniment që ndodh pas dorëzimit të dokumentacionit në FSHF, që përfaqëson një ndryshim domethënës për informacionet e dorëzuara, paraprkisht duhet t'i bëhet i ditur menjëherë FSHF-së.

Neni 13 Licensa e FSHF-së

1. Për të marrë pjesë në kompeticionet e organizuara nga FSHF klubet duhet të pajisen me licensë nga kjo e fundit në përputhje me këtë rregullorë, përveç rastit kur aplikohet Neni 14.
2. Licensa skadon pa paralajmërim, në fund të sezonit për të cilin është lëshuar.

3. Licença nuk mund të transferohet.
4. Licença mund të tërhiqet nga komisionet vendimmarrëse të FSHF-së nëse:
 - a) për ndonjë arsye një subjekt i licensuar falimenton dhe nis likuidimin gjatë sezonit, siç përcaktohet nga ligji kombëtar në zbatim (nëse një subjekt i licensuar falimenton, por hyn në administrim gjatë sezonit, për sa kohë që qëllimi i administrimit është të shpëtojë klubin dhe biznesin, licënca nuk i tërhiqet);
 - b) njëri nga kushtet për lëshimin e një licënca nuk plotësohet më; ose
 - c) subjekti i licensuar thyen ndonjë nga detyrimet që ka ndaj Rregullores së Licensimit të FSHF-së.

Neni 14 Leje të veçanta për pranim në kompeticionet e FSHF-së.

1. Nëse një klub kualifikohet për kompeticionet e FSHF-së bazuar në merita sportive, por nuk i është nënshtruar procesit të plotë apo ka kaluar një proces që është më i ulët/jo ekuivalent me atë që përcaktohet nga kjo Rregullore, klubi në fjalë mund të kërkojë aplikim të jashtëzakonshëm për pjesëmarrje në kompeticionet e FSHF-së në përputhje me Aneksin II.
2. Bazuar në këtë aplikim të jashtëzakonshëm FSHF mund të lëshojë një leje speciale për të hyrë në kompeticionet korresponduese të FSHF-së. Aplikime të tilla të jashtëzakonshme aplikohen për klube të veçanta dhe për sezonin në fjalë.

IV. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 15 – Anekset

Të gjithë anekset e kësaj Rregulloreje janë pjesë përbërëse të saj.

Neni 16 – Kontrolli i përputhjes së auditimit

1. FSHF dhe/ose komisionet/agjencitë e emëruara nga ajo kanë të drejtën që në çdo kohë të kryejnë kontrole të përputhjes së auditimit në prani të aplikantit për licensë.
 2. Kontrollat e përputhjes së auditimit kanë për qëllim të sigurojnë që FSHF-ja si dhe aplikanti për licensë kanë përmbushur detyrimet e tyre dhe se licenca është lëshuar në mënyrë të drejtë pas vendimit përfundimtar të FSHF-së.
-

Neni 17 – Zbatimi i dispozitave

Administrata e FSHF-së duhet të marrë vendimet dhe t'i përshtasë në formë direktivash, në dispozita të detajuara për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 18 – Përshtatja, shfuqizimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore është aprovuar nga Komiteti Ekzekutiv i FSHF-së në mbledhjen e tij më 08.11.2018

Për Komitetin Ekzekutiv të FSHF-së:

President
Armand Duka

Sekretar i Përgjithshëm
Ilir Shulku

ANEKSI I: PROCESI THELBËSOR DHE KRITERET E LICENSIMIT

A – Procesi


Skema e mëposhtme jep të ilustruar procesin thelbësor të ilustruar.


Numrat në skemën më poshtë i referohen sipas një rregulli logjik hapave që duhen ndjekur në procesin e licensimit të një klubi nga aplikanti për licensën e FSHF-së. Skema ndjek numrat nga 1 në 19 (kolona majta). Këta hapa mund të ndiqen aty ku nuk lindin probleme gjatë procesit, pra, nëse një aplikant për licensë plotëson të gjitha kërkesat dhe menaxhimi i aplikantit shkon sipas planit ideal.

Shkronjat në skemë u referohen problemeve të cilat mund të dalin gjatë procesit dhe kanë nevojë të trajtohen në mënyrën e duhur. Skema ndjek shkronjat nga (A) në (I) (kolona në qendër). Kolona djathtas jep një përshkrim të shkurtër për secilin hap.

Shkurtime

ML	- Menaxheri i Licensimit
KLK/FIB	- Komisioni i Shkallës së Parë
KA/AB	- Komisioni i Apelit
S	- Kategoria Superiore
I	- Kategoria e Parë
II	- Kategoria e Dytë





Administrimi i Licensimit

Organet vendimmarrëse

Aplikanti për licensë / i licensuar

B – Kriteret e licensimit

I. KRITERET SPORTIVE

Nr.	KATEGORIA			PËRSHKRIMI
	S	I	II	
S.01	A	A	A	<p>Programi i aprovuar për zhvillimin e të rinjve</p> <p>1 Çdo aplikant për licensën e FSHF-së duhet të ketë një program të shkruar për zhvillimin e të rinjve të aprovuar nga FSHF-ja, i cili duhet të mbulojë të paktën fushat e mëposhtme:</p> <p>a) Objektivat dhe filozofia e zhvillimit të të rinjve;</p> <p>b) Organizimin e sektorit të të rinjve (tabela organizative);</p> <p>c) Personelin (teknik, mjekësor, administrativ) dhe kualifikimi i tyre;</p> <p>d) Infrastruktura (fushat e stërvitjes dhe ndeshjeve) dhe burimet financiare (buxheti dhe kostot). (Dhomë mjekësore me defibrilator);</p> <p>e) Arsimimi futbollistik për çdo grupmoshë;</p> <p>f) Programi i edukimit mbi “Ligjet e lojës“, “Anti-dopingu“ dhe “Integritetin“;</p> <p>g) Mbështetje mjekësore për lojtarët e rinj.</p> <p>h) Procesi i rishikimit për të vlerësuar rezultatet dhe arritjen e objektivave;</p> <p>i) Vlefshmëria e programit.</p>
	A	A		<p>Skuadrat e të rinjve</p> <p>Aplikanti për licensën e FSHF-së duhet të ketë brenda strukturës së tij apo të anëtarësuar në strukturën e tij:</p> <p>a) Të paktën nje skuadër të rinjsh nën moshën 19 vjeç.</p>

Nr.	KATEGORIA			PËRSHKRIMI
	S	I	II	
S.02	A		A	b) Të paktën një skuadër te rinjsh nën moshën 17 vjeç.
	A	A	A	c) Të paktën një skuadër nën moshën 14 vjeç.
	A			d) Të paktën një skuadër nën moshën 10 vjeç (U10).
S.03	A	A	A	Kujdesi ndaj shëndetit të lojtarëve Çdo aplikant për licensën e FSHF-së duhet të sigurojë që të gjithë lojtarët e zgjedhur për të luajtur për skuadrën e parë t'i nënshtrohen një kontrolli mjekësor të përvitshëm, në përputhje me parashtrimet minimale të bëra nga FSHF.
S.04	A	A	A	Regjistrimi i lojtarëve Të gjithë lojtarët e aplikantit për licensën e FSHF-së, përfshirë edhe lojtarët poshtë moshës 10 vjeç, duhet të regjistrohen në FSHF në përputhje me përcaktimet e <i>Rregullores së FIFA-s për Statutin dhe Transferimin e Lojtarëve</i> .
S.05	A	A	C	Kontrata me shkrim e lojtarit profesionist Të gjithë lojtarët profesionistë të aplikantit për licensën e FSHF-së duhet të kenë një kontratë të shkruar me aplikantin për licensë në përputhje me përcaktimet përkatëse të <i>Rregullores së FIFA-s për Statutin dhe Transferimin e Lojtarëve</i> .

II. KRITERET E INFRASTRUKTURËS

Nr.	KATEGORIA			PËRSHKRIMI
	S	I	II	
I.01	A	A	A	<p>Stadiumi për kompeticionet e FSHF-së</p> <ol style="list-style-type: none"> 1 Aplikanti për licensë duhet të ketë një stadium të vlefshëm për kompeticionet e FSHF-së ose të UEFA-s, si dhe fusha stërvitore për ekipin e parë dhe ekipet e sistemit të fëmijëve, i cili duhet të jetë brenda territorit të FSHF-së dhe aprovuar nga kjo e fundit. 2 Nëse aplikanti për licensë nuk është pronar i stadiumit ose i fushave stërvitore, ai duhet të ketë një kontratë me shkrim me pronarin e stadiumit ose të fushave ku do të luajë ekipi (ku të cilësohet që aplikanti për licensë do të zhvillojë ndeshjet në kuadër të kompeticioneve të FSHF-së dhe të UEFA-s), si dhe seancat stërvitore për të gjitha ekipet. 3 Duhet të garantohet që stadiumet mund të përdoren nga aplikanti për ndeshjet “në shtëpi” gjatë sezonit për të cilin kërkohet të licensohet. 4 Stadiumi dhe fushat stërvitore duhet të përmbushin kërkesat minimale të përcaktuara në Rregulloren e FSHF-së (për infrastrukturën e stadioneve) dhe të klasifikohen në nivelet e përcaktuara sipas kategorive ku aplikanti do të luajë. Plus, dhomë mjekësore të pajisur me defibrilator). 5. Aplikanti për Licensë duhet të paraqesë një Certifikatë Sigurie të stadiumit (n.q.s. stadiumi është i pajisur me ndriçim për të luajtur natën, atëherë duhet edhe një Certifikatë nga OSHE, në të cilën të konfirmohet që në këtë stadium mund të zhvillohen takime të Superligës ose të UEFA-s me drita).

III. KRITERET PËR PERSONELIN DHE ADMINISTRATËN

Nr.	KATEGORIA			PËRSHKRIMI
	S	I	II	
P.01	A	A	A	<p>Sekretariati i klubit</p> <p>Çdo klub që aplikon për licensën e FSHF-së apo të UEFA-s duhet të ketë caktuar një staf të kualifikuar, i cili mbështet menaxherin e përgjithshëm në punët e përditshme. Sekretari i klubit duhet të kenë një hapësirë që funksionon si zyrë dhe të jetë e pajisur minimalisht me telefon, fax, kompjuter dhe e-mail.</p>
P.02	A	A	A	<p>Menaxheri i përgjithshëm</p> <p>Aplikanti për licensë duhet të emërojë një menaxher të përgjithshëm, i cili është përgjegjës të drejtojë punët operacionale të klubit. Menaxheri i përgjithshëm duhet të ketë një kontratë të shkruar me aplikantin për licensë.</p>
P.03	A	A	A	<p>Financieri</p> <ol style="list-style-type: none"> 1 Aplikanti për licensë duhet të emërojë një financier të kualifikuar, i cili duhet të jetë përgjegjës për çështjet financiare të aplikantit. 2 Financieri duhet të ketë si minimum një nga kualifikimet e mëposhtme: <ol style="list-style-type: none"> a) Diplomë të njësuar për ekonomi; b) Diplomë audituesi të kualifikuar.
P.04				<p>Përgjegjësi për sigurinë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1 Aplikanti për licensë duhet të ketë punësuar një punonjës sigurie, i cili është i përgjegjshëm për çështjet e ruajtjes së sigurisë.

Nr.	KATEGORIA			PËRSHKRIMI
	S	I	II	
P.04	B	C	C	<p>2 Punonjësi i sigurisë duhet të ketë si minimum një nga kualifikimet e mëposhtme:</p> <p>a) Certifikatë si polic ose person sigurie sipas ligjit në vend;</p> <p>b) Diplomë të ruajtjes së sigurisë të marrë nga një kurs i posaçëm i zhvilluar nga FSHF-ja apo nga një organizatë e njohur nga shteti.</p>
P.05	B	C	C	<p>Përgjegjësi për median</p> <p>1 Aplikanti për licensë duhet të ketë punësuar një punonjës, i cili duhet të jetë përgjegjës për punën me median.</p> <p>2 Përgjegjësi për median duhet të ketë si minimum një ose dy nga kualifikimet e mëposhtme:</p> <p>a) Diplomë në gazetari;</p> <p>b) Diplomë si specialist në media, lëshuar nga FSHF-ja apo një organizatë e njohur nga FSHF-ja.</p>
P.06	A	A	A	<p>Mjeku</p> <p>1 Aplikanti për licensë duhet të punësojë të paktën një mjek, i cili duhet të jetë përgjegjës për mbështetjen mjekësore gjatë lojërave dhe stërvitjes, si dhe për politikën e parandalimit të dopingut.</p> <p>2 Kualifikimet e mjekut duhet të njihen nga autoritetet shëndetësore në vend.</p>
P.07	A	B	B	<p>Fizioterapisti</p> <p>1 Aplikanti për licensë duhet të ketë të punësuar të paktën një fizioterapist, i cili duhet të jetë përgjegjës për trajtimin mjekësor dhe masazhimin e skuadrës së parë gjatë ndeshjeve dhe seancave stërvitore.</p>

Nr.	KATEGORIA			PËRSHKRIMI
	S	I	II	
				2 Kualifikimet e fizioterapistit duhet të njihen nga autoritetet shëndetësore në vend.
P.08	A	A	A	<p>Mjeku i ekipeve të sistemit të fëmijëve: Kontrata, të drejtat, detyrat, afati, emërtimi, kopja e diplomës në mjekësi (Ta ketë ushtruar profesionin minimumi 3 vjet)</p> <p>Trajneri i parë i skuadrës së parë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1 Aplikanti për licensë duhet të punësojë një trajner të parë, i cili është përgjegjës për çështjet futbolistike të skuadrës së parë. 2 Trajneri i parë duhet të zotërojë licensat si më poshtë: <p>Kategoria Superiore:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Licensën UEFA PRO ose; b) Diploma të huaja të vlefshme, të cilat të jenë ekuivalente me ato të kërkuara në pikën a) lart dhe të njohura nga UEFA. <p>Për Kategorinë e Parë</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Licensën UEFA A ose; b) Diploma të huaja të vlefshme, të cilat të jenë ekuivalente me ato të kërkuara në pikën a) lart dhe të njohura nga UEFA. <p>Për Kategorinë e Dytë</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Licensën UEFA B ose; b) Diploma të huaja të vlefshme, të cilat të jenë ekuivalente me ato të kërkuara në pikën a) lart dhe të njohura nga UEFA.
P.09	B	B	C	<p>Asistenti i trajnerit të skuadrës së parë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1 Klubi duhet të kenë të emëruar një trajner të

Nr.	KATEGORIA			PËRSHKRIMI
	S	I	II	
				<p>kualifikuar, i cili të asistojë trajnerin e parë në të gjitha çështjet futbolistike të skuadrës së parë.</p> <p>2 Trajneri i dytë i skuadrës së parë duhet të ketë një nga kualifikimet e mëposhtme:</p> <p>a) Licensën e dytë më të lartë të UEFA-s organizuar nga FSHF-ja (Licensën UEFA A).</p> <p>b) Diploma të huaja të vlefshme, të cilat të jenë ekuivalente me ato të kërkuara në pikën a) lart dhe të njohura nga UEFA.</p>
P.10	B	C	C	<p>Drejtuesi i Programit për Zhvillimin e të Rinjve</p> <p>1 Çdo klub duhet të ketë punësuar një drejtues të kualifikuar për Programin e Zhvillimit të të Rinjve, përgjegjës për drejtimin e punës së përditshme dhe aspektit teknik të sektorit rinor.</p> <p>2 Drejtuesi i programit për zhvillim duhet të ketë një nga kriteret e mëposhtme:</p> <p>a) Licensën e dytë më të lartë të UEFA-s organizuar nga FSHF-ja (Licensën UEFA A).</p> <p>b) Diploma të huaja të vlefshme, të cilat të jenë ekuivalente me ato të kërkuara në pikën a) lart dhe të njohura nga UEFA.</p>
P.11	A	B		<p>Trajnerët e të rinjve</p> <p>1 Aplikantët për licensë duhet të kenë emëruar për çdo skuadër të detyrueshme të të rinjve të paktën një trajner të kualifikuar, i cili është përgjegjës për të gjithë çështjet e futbollit që i përkasin kësaj skuadre.</p> <p>a) Licensën UEFA A ose;</p>

Nr.	KATEGORIA			PËRSHKRIMI
	S	I	II	
			B	<p>b) Diploma të huaja të vlefshme, të cilat të jenë ekuivalente me ato të kërkuara në pikën a) lart dhe të njohura nga UEFA.</p> <p>Për Kategorinë e Dytë</p> <p>2 Trajnerët e të rinjve duhet të kenë kualifikimin minimal të njohur nga FSHF-ja. (UEFA B)</p> <p>Trajneri i portierëve: Kontrata, detyrat, të drejtat, afati, emërtimi, licenca.</p> <p>Përgatitësi atletik: Kontrata, detyrat, të drejtat, afati, emërtimi, kopja e diplomës, kopja e licensës, kualifikime.</p>
P.12	B	B	B	<p>Detyrimi për zëvendësim gjatë sezonit</p> <p>1 Nëse një funksion i përcaktuar në kriteret P.01 deri në P.11 mbetet bosh si pasojë e një vendimi marrë nga i licensuari (p.sh; shkarkimi i trajnerit), i licensuari duhet të sigurojë që në këtë funksion të vihet një person me kualifikimin e nevojshëm.</p> <p>2 Nëse një funksion i përcaktuar në kriteret P.01 deri në P.11 mbetet bosh gjatë sezonit për një arsye jashtë kontrollit të të licensuarit (p.sh; sëmundje, aksident), i licensuari duhet të sigurojë që ai pozicion të zihet nga:</p> <p>a) Një person, i cili ka kualifikimin e duhur (rast në të cilin zëvendësimi mund të jetë për një periudhë kohe të papërcaktuar) ose;</p> <p>b) Një person, i cili nuk e ka kualifikimin e duhur. Në këtë rast zëvendësimi është i përkohshëm dhe nuk mund të zgjasë më shumë se 60 ditë.</p> <p>3 Për zëvendësimin duhet të njoftohet menjëherë FSHF.</p>

IV. KRITERET LIGJORE

Nr.	KATEGORIA			PËRSHKRIMI
	S	I	II	
L.01	A	A	A	<p>Deklarata e pjesëmarrjes në kompeticionet kombëtare të FSHF-së.</p> <p>1 Aplikanti për licensë duhet të dorëzojë një deklaratë ligjërish të vlefshme si më poshtë:</p> <p>a) Njeh si detyrim ligjor statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FSHF-së si dhe juridiksionin e Gjykatës së Arbitrimit për Sportet në Lausanne, siç parashikohet në nenet përkatëse të statuteve të UEFA-s.</p> <p>b) Në nivel kombëtar do të luajë në kompeticionet që janë të njohura dhe nënshkruara nga FSHF-ja.</p> <p>c) Në nivel ndërkombëtar do të marrë pjesë në kampionate të njohura nga UEFA (këtu nuk përfshihen ndeshjet miqësore);</p> <p>d) Do të njoftojë menjëherë FSHF-në për çdo ndryshim, ngjarje dhe kusht me rëndësi ekonomike madhore;</p> <p>e) Do të veprojë në përputhje me rregulloren e licensimit të klubeve të FSHF-së;</p> <p>f) Të gjithë dokumentet e dorëzuar të jenë të plota dhe të sakta;</p> <p>g) Ai autorizon autoritetin kompetent të licensimit të klubeve të shqyrtojë dokumentet dhe të kërkojë informacion nga çdo autoritet përkatës.</p> <p>h) Pranon që UEFA apo FSHF ka të drejtën të ndër marrë kontrollë financiare në nivel kombëtar në përputhje me Nenin 16.</p> <p>2 Deklarata duhet të realizohet nga një nënshkrues i autorizuar jo më shumë se tre muaj para afatit të dorëzimit në FSHF.</p>

Nr.	KATEGORIA			PËRSHKRIMI
	S	I	II	
L.02	A	A	A	<p>Informacion ligjor minimal</p> <ol style="list-style-type: none"> 1 Aplikanti për licensën e FSHF-së duhet të dorëzojë një kopje të statutit të tij aktual, të vlefshëm (p.sh; aktet e kompanisë). 2 Aplikanti për licensën e FSHF-së më tej duhet të paraqesë një ekstrakt nga QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit) për SHA dhe SHPK, ose Vërtetim nga Gjykata për shoqatat jofitimprurëse mbi statusin aktiv të tij, nënshkruar jo më shumë se tre muaj para afatit të dorëzimit në FSHF, e cila përmban informacionet minimale të mëposhtme: <ol style="list-style-type: none"> a) Emri; b) Adresa e zyrave; c) Formular ligjor; d) Lista e nënshkruesve të ligjshëm.

V. KRITERET FINANCIARE

Nr.	KATEGORIA			PËRSHKRIMI
	S	I	II	
F.01	A	A	A	Deklaratat financiare vjetore
				1 Deklaratat financiare vjetore duhet të përgatiten dhe të dorëzohen në përputhje me afatin përfundimtar të përcaktuar në statut, përpara afatit të fundit për dorëzimin e listës për vendimet e licensimit pranë FSHF-së.
				2 Deklarata financiare vjetore duhet të kontrollohet nga një auditues i pavarur, i përcaktuar në Aneksin III.
				3 Deklarata financiare vjetore duhet të përmbajë: <ul style="list-style-type: none"> a) Një pasqyrë bilanci; b) Një pasqyrë fitimesh dhe humbjesh; c) Një pasqyrë e lëvizjes së parasë (cash flow). d) Një vërtetim që të përmbledhë politika financiare dhe vërtetime të tjera shpjeguese; dhe e) Një përmbledhje financiare.
				4 Deklaratat financiare vjetore duhet të plotësojnë kërkesat minimale shpjeguese, siç janë përcaktuar në Aneksin V dhe parimet financiare të përcaktuara në këtë Aneks. Të dhëna krahasuese duhen dorëzuar në përputhje me datën përfundimtare të përcaktuar nga statuti.
5 Nëse kërkesat minimale në përmbajtje dhe llogari siç janë parashtruar në par.4 më lart nuk janë përmbushur në pasqyrën vjetore financiare, atëherë aplikanti duhet të përgatisë informacion shtesë, me qëllim plotësimin e kërkesës për informacion minimal, i cili duhet të vlerësohet nga një auditues i pavarur, siç përcaktohet në Aneksin III				

Nr.	KATEGORIA			PËRSHKRIMI
	S	I	II	
F.02	A	A	A	<p>Asnjë pagesë e vonuar kundrejt klubeve të futbollit</p> <p>1 Aplikanti për licensë duhet të vërtetojë që më 31 dhjetor të vitit përpara sezonit të licensimit nuk ka më pagesa të vonuara (siç është specifikuar në Aneksin VI) kundrejt klubeve të futbollit që rrjedhin nga transfertat.</p> <p>2 Pagesat janë thjesht shuma në drejtim të klubeve të futbollit, që rrjedhin nga kostot direkte të regjistrimit të një lojtari, përfshirë kompensimin për stërvitje dhe kontributet e solidaritetit, siç janë përcaktuar nga <i>Rregulloret e FIFA-s për Statusin dhe Transfertën e Lojtarëve</i>, si dhe klauzolat për kompensim në të ardhmen.</p> <p>3 Aplikanti për licensë duhet të përgatisë dhe të dorëzojë pranë FSHF-së një tabelë pagesash për transfertat, nëse ky informacion nuk është paraqitur tashmë pranë FSHF-së me kërkesat kombëtare për transfertat. Kjo duhet të përgatitet edhe nëse nuk ka pasur transfertat/borxhe gjatë periudhës përkatëse.</p> <p>4 Aplikanti për licensë duhet të shpjegojë të gjitha veprimet për transfertat (përfshirë borxhet) të ndërmarra deri më 31 dhjetor.</p> <p>5 Tabela e pagesave për transfertat (formular tip për t'u përdorur, shiko Aneksin VIII) duhet të përmbajë ndarje të veçanta për secilën transfertë lojtarësh (përfshirë borxhet) pavarësisht nëse ka një shumë të papaguar më 31 dhjetor. Informacionet e mëposhtme duhen dhënë si minimum:</p> <p>a) Lojtari (identifikim me emër apo numër);</p> <p>b) Data e marrëveshjes së transfertës/borxhit;</p> <p>c) Emri i klubit të futbollit ku ka qenë më parë i regjistruar;</p>

Nr.	KATEGORIA			PËRSHKRIMI
	S	I	II	
				<p>d) Taksa e paguar dhe/ose për tu paguar e transfertës ose borxhit (përfshirë kompensim për stërvitje);</p> <p>e) Kosto të tjera për regjistrimin e paguar apo për t'u paguar;</p> <p>f) Shuma e vendosur; dhe</p> <p>g) Bilanci i pagesave deri më 31 dhjetor, përsa i përket çdo transferte lojtari, të detajuar me datat që duhen paguar për çdo element të papaguar të pagesave për transferta.</p> <p>6 Aplikanti për licensë duhet të bashkërendojë detyrimin total të tabelave të pagesave për transferta me bilanci në 'Llogari të pagesave për trasferte lojtarësh'. Aplikanti për licensë kërkohet të raportojë në këtë tabelë të gjitha pagesat edhe nëse pagesa nuk është kërkuar nga kreditori.</p> <p>7 Tabela e pagesave për transferta duhet të miratohet nga drejtuesit dhe kjo duhet të evidentohet me anë të një deklaratë të shkurtër dhe firmë në emër të trupit ekzekutues të aplikantit për licensë.</p>
				<p>Asnjë pagesë e vonuar kundrejt punonjësve dhe autoriteteve sociale dhe të taksave</p> <p>1 Aplikanti për licensë duhet të vërtetojë se më 31 dhjetor të vitit përpara sezonit të aplikimit për licensë nuk ka pagesa të pabëra (siç është specifikuar në Aneksin VI) kundrejt punonjësve si dhe autoriteteve sociale dhe të taksave në përputhje me detyrimet e kontraktuale dhe ligjore me punonjësit.</p>

Nr.	KATEGORIA			PËRSHKRIMI
	S	I	II	
F.03	A	A	A	<p>2 Pagesat janë ato shuma që i takojnë punonjësve dhe autoriteteve sociale dhe të taksave në përputhje me detyrimet kontraktuale dhe ligjore me punonjësit. Shumat që u duhen paguar njerëzve, të cilët për arsye të ndryshme nuk janë më të punësuar nga aplikanti shkojnë për këtë qëllim dhe duhet të paguhen brenda periudhës së përcaktuar në kontratë dhe/ose përcaktuar me ligj, pavarësisht mënyrës që këto pagesa janë konsideruar në deklaratën financiare.</p> <p>3 Termi “të punësuar” përfshin këta persona:</p> <p>a) Të gjithë lojtarët profesionistë sipas <i>Rregulloreve për Statusin dhe Transfertën e Lojtarëve</i>, dhe</p> <p>b) Staf i administrativ, specifikuar në kriterin e Personel/administratës nga P02 deri P.11.</p> <p>4 Aplikanti për licensë duhet të përgatisë një listë me të gjithë të punësuarit, të cilët kanë qenë të punësuar në çdo kohë gjatë vitit deri më 31 dhjetor përpara sezonit të aplikimit për licensim; jo vetëm ata të cilët vazhdojnë të punojnë deri në fund të vitit. Lista duhet t’i dorëzohet FSHF-së.</p> <p>5 Informacioni i mëposhtëm duhet dhënë, si minimum, për çdo punonjës:</p> <p>a) Emri i punonjësit;</p> <p>b) Pozicioni/funksioni i punonjësit;</p> <p>c) Data e fillimit;</p> <p>d) Data e përfundimit (nëse ka); dhe</p> <p>e) Ndonjë pagesë të pabërë deri më 31 dhjetor, bashkë me komentet përkatëse.</p>

Nr.	KATEGORIA			PËRSHKRIMI
	S	I	II	
				<p>6 Të punësuarit duhet të jenë aprovuar nga drejtuesit dhe kjo duhet të jetë vërtetuar nga një deklaratë e shkurtër dhe e firmosur në emër të trupit ekzekutiv të aplikantit për licensë.</p> <p>7 Aplikanti për licensë duhet t'i dorëzojë audituesit dhe/ose FSHF-së provat e dokumentuara të cilat tregojnë shumën për t'u paguar (nëse ka) deri më 31 dhjetorin para sezonit të licensimit, autoriteteve kompetente sociale apo të taksave në bazë të detyrimeve kontraktuale dhe ligjore me punonjësit e tij.</p>
F.04	A			<p>Prezantimet me shkrim para vendimit për licensim</p> <p>1 Brenda shtatë ditësh para fillimit të periudhës në të cilën vendimi për licensim do të merret nga Komisioni i Shkallës së Parë. Aplikanti për licensë duhet të bëjë prezantime me shkrim para FSHF-së.</p> <p>2 Prezantimet me shkrim duhet të konstatojnë nëse ndonjë ngjarje apo kusht i një rëndësie ekonomike madhore ka ndodhur apo jo, që mund të ketë një ndikim të ndryshëm në gjendjen financiare të aplikantit për licensë që prej dorëzimit të bilancit të deklaratës financiare të fundit apo pasqyrës së deklaratës financiare të ndërmjetme (nëse ka).</p> <p>3 Nëse ndonjë eveniment apo kusht me rëndësi ekonomike madhore ka ndodhur, letra e menaxhuesve duhet të përfshijë një përshkrim të natyrës së ngjarjes apo kushtit dhe një vlerësim të ndikimit të tij financiar, apo një deklaratë që një vlerësim i tillë nuk mund të bëhet.</p> <p>4 Miratimi i drejtuesve duhet të vërtetohet me anë të një firme në emër të trupit ekzekutiv të aplikantit për licensë.</p>

Nr.	KATEGORIA			PËRSHKRIMI
	S	I	II	
F.06	A / B*			<p>Informacion financiar për të ardhmen</p> <ol style="list-style-type: none"> 1 Aplikanti për licensë duhet të përpilojë dhe dorëzojë një informacion financiar për të ardhmen rreth ngjarjeve që mund të ndodhin në të ardhmen dhe veprime të mundshme nga drejtues të subjektit raportues. 2 Informacioni financiar për të ardhmen duhet të mbulojë periudhën duke filluar menjëherë pas datës së përfundimit statutor të deklaratës financiare vjetore dhe duhet të mbulojë të gjithë sezonin për licensim. 3 Informacioni financiar për të ardhmen duhet të përgatitet, si minimum, në bazë gjashtë mujore, p.sh; 1 janar deri 30 qershor të vitit në vazhdim. 4 Informacioni financiar për të ardhmen duhet të bazohet në supozime të arsyeshme. 5 Informacioni financiar për të ardhmen konsiston në: <ol style="list-style-type: none"> a) Një buxhet i llogaritur mbi përfitime dhe humbje, i krahasueshëm me vitin financiar të sapombyllur. b) një buxhet i rrjedhjes së parave, i krahasueshëm me vitin financiar të sapombyllur. c) shënime shpjeguese përfshirë supozimet, rreziqet dhe krahasimin me gjendjen e buxhetit aktual.

* **Shënim:** Në rast të shkeljes së treguesve (më sipër) FSHF duhet të ndërmarrë procedura të mëtejshme vlerësimi mbi informacionin e paraqitur dhe, në kushte të caktuara, kjo mund të sigurojë bazën për refuzimin e licensës. Nëse aplikanti nuk ekspozon thyerjen e ndonjë treguesi, atëherë FSHF nuk duhet të ndërmarrë procedura të mëtejshme vlerësimi dhe, në kushte të caktuara, aplikanti mund të sanksionohet, por nuk do t'i refuzohet licensa.

Nr.	KATEGORIA			PËRSHKRIMI
	S	I	II	
				<p>6 Informacioni financiar për të ardhmen duhet të përgatitet në baza të pajtueshme me deklaratën financiare vjetore dhe të ndjekë të njëjtat politika financiare si ato të zbatuara për përpilimin e deklaratës financiare vjetore, përveç ndryshimeve në politikat financiare të ndodhura pas datës së deklaratës së fundit vjetore financiare, që do të pasqyrohen në deklaratën e vitit pasardhës – rast në të cilin kërkohen detaje.</p> <p>7 Informacioni financiar për të ardhmen duhet të plotësojë kërkesat minimale për shqyrtim, siç janë të parashtruara në Aneksin IV. Kolona dhe shënime të reja duhen shtuar nëse sjellin qartësime apo nëse lënia jashtë e tyre mund të çojë në çorientim të informacionit.</p> <p>8 Informacioni financiar për të ardhmen duhet të përfshijë një përshkrim të shkurtër të secilës prej supozimeve të rëndësishme (mund të përmenden lidhjet me aspekte historike financiare dhe informacione të tjera), që janë përdorur për të përpiluar llogaritjet për përfitimet dhe humbjet buxhetore të deklaratës së rrjedhjes së parave, si dhe të përshkruajë shkurtimisht rreziqet kryesore që mund të ndikojnë në rezultat financiar të së ardhmes.</p> <p>9 Informacioni financiar për të ardhmen, me supozimet ku janë bazuar, duhet të jetë i miratuar nga drejtuesit dhe kjo e vërtetuar nga një deklaratë e shkurtër dhe firmën në emër të trupit ekzekutiv të subjektit raportues.</p> <p>10 Në rast se ndonjë nga treguesit e përcaktuar në par. 11 është shkelur, aplikanti për licensë duhet</p>

Nr.	KATEGORIA			PËRSHKRIMI
	S	I	II	
				<p>t'i tregojë FSHF-së aftësinë e tij për të vazhduar aktivitetin fitimprurës deri në fund të sezonit për aplikim.</p> <p>11 Nëse një aplikant për licensë ekspozon njërin nga kushtet e përshkruara në IND. 01, ose IND. 02 (poshtë), aplikanti për licensë duhet të konsiderohet si shkelës i një treguesi.</p> <p>a) IND.01: Raporti i audituesit në përputhje me deklaratën financiare vjetore të dorëzuar në përputhje me Nenin 45 vë theksin mbi problematikën dhe ngre dyshime mbi aktivitetin fitimprurës.</p> <p>b) IND.02: Deklarata vjetore financiare (përfshirë informacion shtesë, kur kërkohet) e dorëzuar në përputhje me kriterin F.01 paraqet një gjendje të përkeqësuar detyrimesh krahasuar me shifrat e afatit të mëparshëm statutor.</p>

ANEKSI II: APLIKIME TË JASHTËZAKONSHME TË SISTEMIT TË LICENSIMIT TË KLUBEVE

- 1 Klubi përkatës duhet të njoftojë Administratën e FSHF-së për mundësinë e një aplikimi të tillë të jashtëzakonshëm me shkrim, maksimalisht më 31 maj.
- 2 FSHF përcakton kriteret minimale për aplikimet e jashtëzakonshme të sistemit të licensimeve të klubeve, siç është specifikuar në Nenin 14 (1) përcakton afatet e nevojshme dhe ia dërgon këto klubit përkatës.
- 3 Klubi/klubet e interesuara duhet të sigurojnë dokumente të nevojshme prove për FSHF-në, e cila do të vlerësojë klubin/klubet për plotësimin e kërkesave minimale të vendosura.
- 4 FSHF e bazon vendimin e saj në dokumentet që ka marrë dhe jep leje të veçantë për të hyrë në kompeticionet e FSHF-së mes klubeve, nëse të gjithë kriteret e përcaktuara janë plotësuar.
- 5 Nëse një klub eliminohet nga performanca sportive gjatë procedurës së jashtëzakonshme, Administrata e FSHF-së ndërpret procedurën menjëherë, pa një vendim të mëtejshëm. Një procedurë e tillë e ndërprerë nuk mund të rinisë në një fazë tjetër.

ANEKSI III: PËRCAKTIMI I AUDITUESIT DHE PROCEDURAVE VLERËSUERE TË TIJ

A – Të përgjithshme

- 1 Audituesi (kontrollori financiar) duhet të jetë i pavarur në përputhje me Shoqatën Ndërkombëtare të Financierëve, (IFAC) Kodi i Etikës për Financierë Profesionistë (shih kriterin F.01)
- 2 Audituesi duhet të jetë anëtar i një nga organet përkatëse të IFAC. Nëse nuk ka asnjë auditues anëtar të saj brenda territorit të aplikantit për licensë, aplikanti për licensë duhet të përdorë një auditues të pavarur, të cilit i lejohet nga ligji kombëtar të kryejë punën audituese.

B – Procedurat e vlerësimit

- 1 Audituesi duhet të kontrollojë pasqyrat financiare vjetore. Raporti i tij duhet:
 - a) të përfshijë një deklaratë, e cila konfirmon se auditimi është zhvilluar sipas procedurave të miratuara të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ose standardeve apo praktikave kombëtare përkatëse të auditimit në përputhje, si minimum me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit; dhe
 - b) t'i paraqesë në FSHF bashkë me deklaratën financiare vjetore për të hedhur bazat e vendimit për licensim.
- 2 Audituesi duhet të vlerësojë informacionet shtesë, nëse ka. Raporti i tij mbi faktet e gjetura duhet:
 - a) të përfshijë një deklaratë që konfirmon se vlerësimi është zhvilluar sipas procedurave të miratuara të Standardeve Ndërkombëtare për Shërbime 4400 ose standardeve apo praktikave kombëtare

- përkatëse të vlerësimit në përputhje, si minimum me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Shërbimit; dhe
- b) t'i paraqesë në FSHF bashkë me informacionin shtesë për të hedhur bazat e vendimit për licensim.
- 3 Informacioni financiar, ashtu si deklarata financiare, mund të vlerësohet nga një auditues. Raporti i tij rreth fakteve të gjetura duhet:
- a) të përfshijë një deklaratë që konfirmon se vlerësimi është zhvilluar sipas procedurave të miratuara të Standardeve Ndërkombëtare për Shërbime 4400 ose standardeve apo praktikave kombëtare përkatëse të vlerësimit në përputhje, si minimum me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare për Shërbime; dhe
 - b) t'i paraqesë në FSHF bashkë me dokumentet përkatëse për të hedhur bazat e vendimit për licensim.

ANEKSI IV: KËRKESAT MINIMALE SQARUESE

A – Të përgjithshme

- 1 Pavarësisht kërkesave të praktikave kombëtare të financave, kriteret financiare kërkojnë që aplikantët për licensë të paraqesin një nivel specifik minimal informacioni financiar FSHF-së, siç është parashtruar në Kriteret F.01, dhe F.06.
- 2 Çdo përbërës i deklaratës financiare duhet të identifikohet qartësisht. Informacioni i mëposhtëm duhet të paraqitet dukshëm dhe të përsëritet aty, këtu është nevoja brenda deklaratës financiare, në mënyrë që të kuptohet sa më mirë informacioni i paraqitur:
 - a) Emri (dhe forma ligjore), vendbanimi dhe adresa e biznesit për subjektin e raportuar dhe çdo ndryshim i këtij informacioni deri në afatin e fundit;
 - b) Nëse informacioni financiar mbulon një aplikant individual, një grup subjektesh apo ndonjë kombinim tjetër subjektesh dhe një përshkrim të strukturës së një grupi apo strukture të tillë;
 - c) Data statutore e mbylljes dhe periudha e mbuluar nga informacioni financiar (të informacionit aktual dhe atij krahasues); dhe
 - d) Prezantimi i monedhës.

B – Pasqyrat e bilancit

- 1 Kërkesat minimale të përmbajtjes së bilancit janë të parashtruara më poshtë:

Asete rrjedhëse

- i) paratë dhe ekuivalentët e tyre;
- ii) llogaritë nga të ardhurat e transfertës së lojtarëve;

iii) llogaritë nga grupet e subjekteve dhe palët përkatëse (shih par. 3c);

iv) llogaritë nga të tjera;

v) inventaret;

Asetet jo rrjedhëse

vi) asetet fikse të prekshme (shih par. 3a);

vii) asetet e paprekshme – lojtarët (shih par. 3a);

viii) asetet e paprekshme – të tjera (shih par. 3a);

ix) investimet (shih par. 3b);

Detyrime rrjedhëse

x) overdraftet dhe huatë;

xi) llogaritë për t'u paguar lidhur me transfertën e lojtarëve;

xii) llogaritë për t'u paguar për grupet e subjekteve dhe palët përkatëse (shih. 3c);

xiii) llogaritë për t'u paguar - të tjera;

xiv) detyrimet tatimore;

xv) dispozitat afatshkurtra (shih par. 3d);

Detyrimet jo rrjedhëse

xvi) huatë e bankave dhe të tjera;

xvii) detyrime të tjera afatgjata;

xviii) detyrimet tatimore;

xix) dispozitat afatgjata (shih par. 3d);

Asetet në rrjet/detyrimet

xx) asetet në rrjet/detyrimet (shih par. 3e);

Kapitali

xxi) aksionet e thesarit;

xxii) kapitali i emetuar dhe rezervat (shih par. 3f).

- 2 Drejtuesit mund të vendosin nëse artikujt në rresht (i) deri (xxii) mund të prezantohen më mirë në pjesën e parë të bilancit dhe informacioni shtesë (përshkruar më poshtë) si shënime.
- 3 Kërkesat minimale për informacion lidhur me bilancin duhet të përfshijnë gjithashtu:
 - a) Në lidhje me asetet e prekshme dhe të paprekshme, një bashkërendim të shumës në fillim dhe në fund të periudhës, që të tregojë shitjet, rivlerësimet, joproduktivitetin, zhvlerësimet/amortizimet dhe ndonjë ndryshim tjetër.
 - b) Investimet duhet të përfshijnë investime të filialeve, subjekteve në kontroll të përbashkët dhe shoqatave. Lidhur me investimet në filiale, subjektet në kontroll të përbashkët dhe shoqatave, si minimum, informacioni i mëposhtëm duhet të jepet për çdo investim:
 - i) Emri;
 - ii) Vendi i themelimit apo rezidencës;
 - iii) Llojet e biznesit/operationet e subjekteve;
 - iv) Raportet e interesit mbi pronësinë;
 - v) Raportet e fuqisë së votës, dhe
 - vi) Një përshkrim të metodës së përdorur për të llogaritur investimet.
 - c) Nënklasifikim i bilancit total për të përshkruar veçmas shuma të marra nga grupe subjektësh dhe shuma të marra nga palë të tjera; si dhe nënklasifikime të bilancit total për të përshkruar veçmas shuma të paguara të grupeve të subjekteve dhe palëve të tjera.

- d) Për çdo grup dispozitash, përshkrim i shumës ekzistuese në fillim dhe fund të periudhës, shuma e përdorur dhe e zhbllokuar apo kredituar, gjatë kësaj periudhe.
- e) Asetet/borxhet në rrjet, duke qenë përbërës të asetëve totale, më pak borxhe totale janë përdorur për të përcaktuar nëse aplikanti për licensë është shkelës i treguesit IND. 02, siç është përshkruar në Kriterin F.06.
- f) Nënklasifikim i bilancit total të kapitalit të lëshuar dhe rezervë për të përshkruar veçmas aksionet kapitale, aksionet prim, rezerva të tjera, përfitime të ruajtura.

C – Përfitimet dhe humbjet

- 1 Kërkesat minimale për përmbajtjen e llogarisë së përfitimeve dhe humbjeve janë të përcaktuara më poshtë.

Të ardhurat

- i) arkëtimet nga shitjet e biletave;
- ii) sponsorizimet dhe publiciteti;
- iii) të drejtat e transmetimit;
- iv) reklama;
- v) të ardhura të tjera operative;

Shpenzimet

- vi) kostot e shitjeve/materialet;
- vii) shpenzimet për përfitimet e punonjësve;
- viii) zhvlerësimi dhe amortizimi (shih par. 2a);
- ix) joproduktiviteti i asetëve fikse (shih par. 2b);
- x) shpenzime të tjera operative;

Të tjera

- xi) përfitimi/humbja në shitjen e asetëve (shih par. 2c);
 - xii) kostot financiare;
 - xiii) shpenzimet financiare për taksë;
 - xiv) përfitimi dhe humbja pas vënies së taksave.
- 2 Kërkesat minimale për informacion lidhur me disa llogari përfitimi dhe humbjeje përfshijnë gjithashtu:
- a) Sqarime të veçanta, kërkuar për zhvlerësimin e asetëve të prekshme, zhvlerësimin e kostove të regjistrimit të një lojtari dhe zhvlerësimin e asetëve të tjera të paprekshme.
 - b) Sqarime të veçanta, kërkuar për mangësitë e kostove të regjistrimit të një lojtari dhe mangësitë e asetëve të prekshme dhe të paprekshme.
 - c) Sqarime të veçanta, kërkuar për përfitimet dhe humbjet nga shitja e regjistrimit të lojtarëve (apo të ardhurat dhe kostot kur regjistrimi i lojtarëve nuk është shfrytëzuar) dhe përfitimet dhe humbjet nga shitjet e të tjera asetë të prekshme dhe të paprekshme.

D – Pasqyrat e parave rrjedhëse (cash flow)

- 1 Pasqyra e parave rrjedhëse (cash flow) duhet të raportojë rrjedhjen e parave për periudhën financiare (dhe krahasim me periudhën e mëparshme financiare) të klasifikuar veçmas në aktivitete operuese, investuese dhe financuese, në mënyrën që drejtuesit e konsiderojnë më të përshtatshme.
- 2 Përbërësit e parave dhe ekuivalenteve të tyre duhet të përshkruhen dhe duhet të prezantohen si një bashkërendim i shumave në deklaratën e parave rrjedhëse me artikujt ekuivalentë të raportuara në bilanc.

E – Shënimet në pasqyrën financiare

1 Shënimet në pasqyrën financiare vjetore duhet të prezantohen në mënyrë të sistemuar. Çdo artikulli në bilanc, llogarive të përfitimit dhe humbjes dhe deklaratave të parave të rrjedhshme duhet t’i vendoset një shenjë poshtëshënimi nëse kanë lidhje me informacionet në shënime. Kërkesat minimale për përshkrimet që duhet të përfshihen në shënime janë:

a) Politikat financiare

Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe një përmbledhje e politikave financiare të rëndësishme të përdorura.

b) Pala kontrolluese

Kur subjekti raportues kontrollohet nga një palë tjetër, duhet të ketë një përshkrim të marrëdhënies me këtë palë, emrin e këtij subjekti tjetër dhe, nëse i ndryshëm, emrin e palës së fundit kontrolluese. Nëse pala kontrolluese apo pala e fundit kontrolluese e subjektit të raportuar nuk është e njohur, ky fakt duhet të paraqitet. Ky informacion duhet të bëhet i njohur, pavarësisht nëse ka pasur ndonjë transaksion mes palëve kontrolluese dhe subjektit raportues.

c) Transaksionet e palëve të lidhura

Nëse ka pasur transaksione mes palëve të lidhura gjatë periudhës, subjekti raportues duhet të përshkruajë natyrën e marrëdhënies me palën e lidhur, si dhe informacion rreth transaksioneve gjatë periudhës dhe bilancin e papaguar deri në fund të periudhës, të nevojshme për të kuptuar efektin potencial të marrëdhënies në deklaratën përfundimtare.

Si minimum, sqarimet duhet të përfshijnë:

i) shumën e transaksioneve;

ii) shumën e bilancit të papaguar dhe:

- afatet dhe kushtet e tyre, nëse ata sigurohen, si dhe natyrën e marrëdhënies; dhe
- detaje të ndonjë garancie të dhënë apo të marrë;

- iii) kushtet për borxhet e dyshimta lidhur me shumën e bilancit të papaguar; dhe
- iv) shpenzimet gjatë periudhës në lidhje me borxhet e këqija dhe të dyshimta, si pasojë e palëve të ndërlidhura.

d) Asetet e lëna peng dhe asetet si rezervë pronësie

Ekzistenca dhe vlera e rezervave të pronësisë dhe prona, impiantet dhe pajisjet të vëna si peng për sigurinë e detyrimeve ose garancive duhet të përshkruhen.

e) Detyrimet e mundshme

Nëse mundësia e ndonjë shlyerje detyrimi është e largët, subjekti raportues duhet të bëjë për çdo detyrim të mundshëm, në afatin statutor të përcaktuar, një përshkrim të shkurtër të natyrës së detyrimit dhe, aty ku praktikohet:

- v) një vlerësim të efektit të tij financiar;
- vi) një tregues të pasigurisë lidhur me shumën apo afatin e ndonjë rrjedhjeje;
- vii) mundësinë e ndonjë rimbursimi.

e) Sqarime të tjera

Ndonjë informacion shtesë apo sqarim i cili nuk është paraqitur në bilanc, deklaratën e përfitimeve dhe humbjeve apo deklaratën e rrjedhjes të parave, por është i rëndësishëm për të kuptuar këto deklarata dhe/ose kërkohet për të plotësuar kërkesat minimale të informacionit financiar.

- 2 Shënimet për pasqyrat financiare të ndërmjetme duhet të përmbajnë:
- a) një deklaratë se politika të njëjta financiare dhe metoda llogaritjeje janë përdorur në pasqyrat financiare të ndërmjetme krahasuar me pasqyrën financiare vjetore më të fundit ose nëse këto politika apo metoda janë ndryshuar, një përshkrim i natyrës dhe efektit të ndryshimeve, dhe
 - b) një sqarim i transaksioneve, të cilat mund të shërbejnë në kuptimin e kësaj periudhe të ndërmjetme.

F – Shqyrtimi financiar nga drejtuesit

- 1 Pasqyrat financiare vjetore duhet të përfshijnë një shqyrtim financiar ose komentim nga menaxhuesit (njohur si raporti i drejtuesve) që përshkruan dhe sqaron tiparet kryesore të paraqitjes financiare të subjektit të raportuar, si dhe pozicionin financiar dhe rreziqet kryesore e pasiguritë me të cilat ai përballet.
- 2 Pasqyrat financiare vjetore duhet të përfshijnë gjithashtu emrat e personave anëtarë të bordit ekzekutiv dhe drejtues dhe trupat mbikëqyrëse të subjekteve raportuese në çdo kohë gjatë vitit.

ANEKSI V: BAZAT PËR TË PËRPILUAR NJË PASQYRË FINANCIARE

A – Parimi

- 1 Pasqyrat financiare, siç janë përcaktuar në Kriterin F.01, duhet të bazohen në standardet financiare të kërkuara nga legjislacioni vendor për kompanitë e bashkuara – ose struktura e aplikueshme e raportimit financiar të vendit përkatës – pavarësisht nga struktura ligjore e aplikantit për licensë.
- 2 Pasqyrat financiare duhet të përpilohen me supozimin, se aplikanti për licensë është fitimprurës. Supozohet se aplikanti për licensë nuk ka as ndërmendjen dhe as nevojën për likuidim, të pushojë së punuari apo kërkojë mbrojtje nga kreditorët sipas ligjeve dhe rregulloreve.
- 3 Struktura e raportit financiar, e përshtatshme si bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare, duhet të përmbajë disa principe të përfshira:
 - a) Prezantim i drejtë;
 - b) Prezantim i rrjedhshëm;
 - c) Baza të forta përlllogaritëse;
 - d) Prezantim i veçantë për çdo grup artikujsh;
 - e) Të mos ketë kundërpeshim mes aseteve dhe detyrimeve dhe mes të ardhurave dhe shpenzimeve, përjashtuar rastet kur lejohet nga praktikat kombëtare.
- 4 Kompensimi që u paguhet lojtarëve nga detyrimet kontraktuale apo ligjore dhe gjithë të ardhurat nga arkëtimet nga shitjet e biletave duhet të shpjegohen në librin e llogarive të aplikantit për licensë ose në librat e një prej subjekteve të bashkuara.
- 5 Pasqyrat financiare duhet të aprovohen nga drejtuesit dhe kjo duhet të vërtetohet nga një deklaratë e shkurtër, e firmosur në emër të trupit ekzekutiv dhe subjektit raportues.

B – Llogaritë për kostot e regjistrimit të një lojtari

- 1 Sipas praktikave financiare kombëtare, subjekti raportues (d.m.th, Klubi) kërkohet të paguajë kostot e regjistrimit të një lojtari, gjë e cila duhet të përfshihet në Pasqyrën Financiare Vjetore, siç parashikohet në Kriterin F.01 dhe Aneksin IV).

ANEKSI VI: NOCIONI I “PAGESAVE TË VONUARA”

- 1 Pagesat e përcaktuara në Kriteret F. 02 dhe F.03 duhet të konsiderohen si të vonuara, nëse ato nuk janë paguar sipas kushteve të vendosura.
- 2 Lidhur me sistemin e licensimit, një pagesë e vonuar më 31 dhjetor nuk konsiderohet si e vonuar, nëse aplikanti për licensë është në gjendje të vërtetojë deri në 31 marsin tjetër që:
 - a) kushti është plotësuar, d.m.th., paguar plotësisht pagesa e vonuar, përveç rastit kur është rënë dakord individualisht me kreditorin; ose
 - b) ka bërë një marrëveshje të shkruar me kreditorin për të shtyrë afatin e pagesës së këtyre pagesave të vonuara (shënim: nëse kreditori nuk ka kërkuar pagimin e një pagese të vonuar, kjo nuk konsiderohet një zgjatje e afatit të pagesës); ose
 - c) pretendime ligjore janë ngritur dhe janë gjykuar si të pranueshme nga autoritetet kompetente sipas legjislacionit kombëtar apo nëse janë hapur procedura me autoritetet statutorë kombëtare apo ndërkombëtare të futbollit apo me gjykatën përkatëse, lidhur me këto pagesa të vonuara. Nëse komisionet vendimmarrëse gjykojnë se procedurat mund të jenë hapur nga aplikanti për licensë me qëllimin e vetëm të sjellin pagesat e vonuara në diskutim (në mënyrë që të krijojnë një situatë siç u përshkrua më lart dhe të fitojnë kohë), FSHF-ja mund të kërkojë prova shtesë në mënyrë që të bindet se nuk është një pretendim qartësisht pa baza.

ANEKSI VII: PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË FSHF-së

A – Të përgjithshme

Procesi i vlerësimit, i cili kontrollon përputhjen me kriteret financiare të përcaktuara në Nenin 9 u referohet hapave specifike të vlerësimit, që duhet të ndiqen nga FSHF-ja, siç janë përcaktuar më poshtë.

B – Vlerësimi i raportit të audituesit në pasqyrat financiare vjetore

- 1 Për sa i përket pasqyrës financiare vjetore, FSHF duhet të ndjekë, si minimum, procedurat e mëposhtme të vlerësimit:
 - a) Të vlerësojë nëse subjekti i raportuar është i përshtatshëm si Klub për t'u licensuar.
 - b) Të vlerësojë informacionet e dorëzuara (raportet financiare vjetore dhe të ndërmjetme, të cilat mund të përfshijnë gjithashtu informacione shtesë) për të hedhur bazat e vendimit për licensimin e tij.
 - c) Të lexojë dhe vlerësojë pasqyrat financiare vjetore dhe të ndërmjetme, si dhe raportin e revizorit mbi këto të fundit.
 - d) T'ia adresojë pasojat e ndonjë modifikimi auditit dhe/ose të rishikojë raportin (krahasuar me një formular raporti pa kufizime) dhe/ose ndryshimet krahasuar me kërkesat minimale për përshkrim dhe llogari sipas par. 2 më poshtë.
- 2 Pasi ka lexuar raportin e audituesit mbi pasqyrën financiare vjetore, FSHF-ja duhet të vlerësojë atë sipas artikujve të mëposhtëm:
 - a) Nëse raporti i audituesit ka një opinion pa kufizime, pa modifikime, kjo përbën një bazë të mirë për garantimin e licensës.
 - b) Nëse raporti i audituesit nuk ka opinion apo ka opinion kundër, licensa duhet të refuzohet. Vetëm nëse një vlerësim tjetër auditit me një opinion jo kundër sigurohet (në lidhje me të tjera pasqyra

- financiare të njëjtit vit, të cilat ti plotësojnë kërkesat minimale) dhe FSHF-ja të jetë e kënaqur me opinionin pasardhës të audituesit.
- c) Nëse raporti i audituesit, vë theksin mbi problematikën dhe dyshon mbi aftësinë e subjektit për të qenë fitimprurës, licenca duhet të refuzohet. Përrjashtuar rastet kur:
- i) një opinion tjetër i auditit për të njëjtin vit financiar hedh poshtë sa më sipër; ose
 - ii) dokumente shtesë tregojnë aftësinë e aplikantit për licensë për të qenë fitimprurës deri të paktën në fund të sezonit të licensimit, i janë dorëzuar FSHF-së dhe kjo e fundit i ka vlerësuar si të kënaqshme. Dokumente me informacione shtesë përfshijnë, por jo detyrimisht vetëm, informacionin e përshkruar në Nenin 50 (informacion për të ardhmen).
- d) Nëse raporti i audituesit vë theksin mbi problematikën dhe dyshon mbi aftësinë e subjektit për të qenë fitimprurës, atëherë FSHF-ja duhet të konsiderojë përfshirjen e modifikimeve me qëllim licensimin e Klubit. Licenca duhet të refuzohet, përveç kur sillen dokumente shtesë, të cilat janë dorëzuar dhe vlerësuar si të kënaqshme nga FSHF-ja. Prova shtesë që mund të kërkohen nga FSHF-ja do të varen nga arsyeja e modifikimit të raportit të auditimit.
- 3 Nëse aplikanti për licensë siguron informacione shtesë, FSHF-ja duhet vlerësojë edhe raportin e audituesit mbi procedurat e miratuara në lidhje me informacionin shtesë. Licenca mund të refuzohet nëse kjo përfshin referencë gabimesh dhe/ose përjashtimesh.

C – Vlerësimi i pagesave të vonuara kundrejt klubeve të tjera

- 1 Në lidhje me pagesat e vonuara kundrejt klubeve të tjera, vlerësimi do të bëhet nga audituesit e klubeve dhe FSHF-ja do të shqyrtojë këtë punë përmes ekspertëve të saj.
- 2 Vlerësimi i audituesit duhet të bëhet sipas procedurave në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Shërbimeve 4400 ‘Zotimi për të Vepruar sipas Procedurave të Miratuara lidhur me Informacionin Financiar’.

- 3 Ky standard, gjithashtu, është një guidë për përgjegjësitë profesionale të audituesit, kur ky merr një angazhim për të vepruar sipas procedurave që ai ka ndërmarrë si dhe rreth formës dhe përmbajtjes së raportit që audituesi lëshon në lidhje me këtë angazhim.
- 4 Procedurat e miratuara duhet të përfshijnë hapat e mëposhtëm të kontrollit:
 - a) Përputhjen e totalit të tabelës së pagesave të transfertave me shumën e “Llogarive të pagesave lidhur me transfertat e lojtarëve” në pasqyrën financiare vjetore të 31 dhjetorit.
 - b) Kontrollin matematik të përputhjes së tabelave të pagesave të transfertave.
 - c) Përzgjedhjen e një kampioni të rastësishëm nga transfertat/borxhet e lojtarëve, krahasimin e marrëveshjes korresponduese me informacionin e tabelës dhe nënvijëzimin e transfertës/borxhit.
 - d) Përzgjedhjen e një shembulli transferimi pagesash, krahasimin me informacionin që përmban tabela e pagesave të transfertave dhe nënvijëzimi i pagesave të përzgjedhura.
 - e) Nëse sipas tabelës së transfertave të pagesave ka një pagesë që duhej bërë deri më 31 dhjetor, të verifikohet se, para 31 marsit:
 - i) Çdo pagesë që duhej bërë deri 31 dhjetor ka përfunduar; ose
 - ii) Një marrëveshje është nënshkruar për ndryshimin e afateve të pagesës; ose
 - iii) Një konflikt ka lindur dhe pret zgjidhje nga trupat kombëtare apo ndërkombëtare.
 - f) Nëse është e aplikueshme: marrjen dhe shqyrtimin e deklaratave bankare, në mbështetje të pikës e(i) më lart.
 - g) Nëse është e aplikueshme: marrjen dhe shqyrtimin e dokumenteve, përfshirë marrëveshjet me klubin/klubet e futbollit përkatëse dhe/ose korrespondencën me komisionin kompetent, në mbështetje të pikës e(ii) dhe/ose e(iii) lart.

D – Vlerësimi i pagesave të vonuara kundrejt punonjësve dhe autoriteteve të sociale dhe të taksave

- 1 Për sa i përket pagesave të vonuara kundrejt punonjësve dhe autoriteteve sociale dhe të taksave vlerësimi do të bëhet nga audituesit e klubeve dhe FSHF-ja do të shqyrtojë këtë punë me anë të ekspertëve të saj.
- 2 Vlerësimi nga audituesit duhet të kryhet sipas procedurave të miratuara sipas Standardeve Ndërkombëtare për Shërbimet 4400 ‘Zotimi për të Vepruar sipas Procedurave të Miratuara lidhur me Informacionin Financiar’ (shih edhe Aneksin IV).
- 3 Ky standard, gjithashtu, është një guidë për përgjegjësitë profesionale të audituesit, kur ky merr një angazhim për të vepruar sipas procedurave si dhe rreth formës dhe përmbajtjes së raportit që ai lëshon në lidhje me këtë angazhim.
- 4 Procedurat e miratuara duhet të përfshijnë hapat e mëposhtëm të kontrollit në lidhje me pagesat e punonjësve:
 - a) Marrjen e listës së punonjësve të përgatitur nga drejtuesit.
 - b) Marrjen dhe inspektimin e një kampioni të rastësishëm të vërtetimeve të punonjësve dhe krahasimi i informacionit me atë që përmban lista e të punonjësve.
 - c) Nëse sipas tabelës së transfertave të pagesave ka një page që duhej bërë deri më 31 dhjetor, të verifikohet se, para 31 marsit:
 - i) Çdo pagesë që duhej bërë deri 31 dhjetor ka përfunduar; ose
 - ii) Një marrëveshje është nënshkruar për ndryshimin e afateve të pagesës; ose
 - iii) Një konflikt ka lindur dhe pret zgjidhje nga trupat kombëtare apo ndërkombëtare.
 - d) Nëse është e aplikueshme: marrjen dhe shqyrtimin e deklaratave bankare, në mbështetje të pikës c(i) më lart.
 - e) Nëse është e aplikueshme: marrjen dhe shqyrtimin e dokumenteve, përfshirë marrëveshjet me punonjësit përkatës dhe/ose korrespondencën me komisionin kompetent, në mbështetje të pikës c(ii) dhe/ose c(iii) lart.

- 5 Procedurat e miratuara duhet të përfshijnë hapat e kontrollit të mëposhtëm, lidhur me pagesat drejt autoriteteve sociale dhe të taksave:
- a) Përputhjen e bilancit të listpagesave të taksave para 31 dhjetorit me dokumentet e klubit.
 - b) Nëse sipas FSHF-së ka një shumë, e cila duhej paguar deri më 31 dhjetor, duhet të vërtetohet para 31 marsit:
 - i) Çdo pagesë që duhej bërë deri 31 dhjetor ka përfunduar; ose
 - ii) Një marrëveshje është nënshkruar për ndryshimin e afateve të pagesës; ose
 - iii) Një konflikt ka lindur dhe pret zgjidhje nga trupat kombëtare apo ndërkombëtare.
 - c) Nëse është e aplikueshme: marrjen dhe shqyrtimin e deklaratave bankare, në mbështetje pikës b(i) më lart.
 - d) Nëse është e aplikueshme: marrjen dhe shqyrtimin e dokumenteve, përfshirë marrëveshjet me autoritetet sociale dhe të taksave dhe/ose korrespondencën me komisionin kompetent, në mbështetje të pikës b(ii) dhe/ose b(iii) lart.

E – Vlerësimi i letrës së prezantimit me shkrim

- 1 Në lidhje me letrën e prezantimit, vlerësimi do të bëhet nga audituesit e Klubit dhe FSHF-ja do të shqyrtojë këtë punë me anë të ekspertëve të saj.
- 2 Për sa i përket letrës së prezantimit, FSHF-ja duhet ta lexojë dhe vlerësojë informacionin në lidhje me ndonjë fakt apo kusht të rëndësishëm ekonomike, në kombinim me deklaratat financiare, informacionin financiar për të ardhmen dhe ndonjë prove të dokumentuar të dorëzuar nga aplikanti për licensë. FSHF-ja mund të vendosë të bëjë këtë vlerësim me ndihmën e një audituesi.
- 3 FSHF-ja duhet të vlerësojë aftësinë e Klubit për të vazhduar aktivitetin fitimprurës deri të paktën në fund të sezonit të licensimit. Licensa duhet refuzuar, nëse bazuar në informacionin financiar që FSHF-ja ka

vlerësuar, në gjykim të FSHF-së aplikanti për licensë mund të mos jetë në gjendje të vazhdojë aktivitetin fitimprurës deri të paktën në fund të sezonit të licensimit.

F – Vlerësimi për informacionin financiar të së ardhmes

- 1 Për sa i përket informacionit financiar për të ardhmen, FSHF-ja duhet të vlerësojë nëse janë shkelur apo jo treguesit e përcaktuar në Nenin 50. Nëse një tregues është shkelur, FSHF-ja duhet të vlerësojë informacionin financiar për të ardhmen më gjerësisht, siç është përcaktuar në par. 2 më poshtë.
- 2 Procedurat e vlerësimit, të cilat mund të ndërmerren nga një auditues, duhet të përfshijnë, si minimum, sa më poshtë:
 - a) të kontrollohet nëse informacioni financiar për të ardhmen është matematikisht i saktë.
 - b) përmes bisedimeve me drejtuesit dhe shqyrtimin e informacionit financiar për të ardhmen, të përcaktohet nëse informacioni financiar për të ardhmen është përgatitur, duke përdorur supozimet e përshkruara dhe rreziqet e mundshme.
 - c) të kontrollohet nëse bilancet fillestare të informacioneve financiare për të ardhmen përputhen me bilancin e paraqitur në deklaratën financiare vjetore të audituar të vitit pasardhës ose deklaratës financiare të ndërmjetme të shqyrtuar (nëse një deklaratë e tillë e ndërmjetme është dorëzuar); dhe
 - d) të kontrollohet nëse informacioni financiar për të ardhmen është aprovuar formalisht nga trupi ekzekutiv i aplikantit për licensë.
- 3 FSHF-ja duhet të vlerësojë aftësinë e Klubit për të vazhduar punën deri të paktën në fund të sezonit të licensimit. Licensa duhet refuzuar, nëse bazuar në informacionin financiar që FSHF-ja ka vlerësuar, në gjykim të FSHF-së, aplikanti për licensë mund të mos jetë në gjendje të vazhdojë punën deri të paktën në fund të sezonit të licensimit.

ANEKSI VIII: TABELA E PAGESAVE PËR TRANSFERTA

Tabela e Pagesave për Transfertat e (Emri i Klubit)

Detajet e lojtarit								Shuma e paguar			Shuma në pagim deri më 31 Dhjetor 2018					
Emri	Data e marrëveshjes së transfertës së huazimit	Nga Klubi	Kostot direkte për rregjistrimin				Totali kostove direkte deri më 31 dhjetor 2017	Totali i shumës së paguar deri më dt. 31 dhjetor 2017	Data e pagesës	Totali i shumës në pagim për dt. 31 dhjetor 2017	Për Klube e Futb.	Datat për pagesat	Për palët e treta	Pagesa transf. të kushtëz. të panjohura deri më dt. 31 dhjetor 2018 (pjesë e borxhit)	Gjendja me dt. 31 dhjet. 2017	Konkluzioni pasues pas 31 mars 2018
			Tarifa pa kushtëzim e huazimit për klubin e mëparsh.	Tarifat e transferimit të rëna dakort	Kompens. për trajnimin/kontributin e solidaritetit	Kosto të tjera direkte										
Lojtari a	15.08.17	klub w	100	-	50	150	-	-	150	150	15.10.17	-	-	Pagese e vonuar	OK (paguar me 31 jan 2018)	
Lojtari b	15.07.17	klub x	280	-	20	300	100	15.10.17	<u>120</u> 80	<u>100</u> 80	<u>30.11.17</u> 30.06.18	<u>20</u> -	-	Pagese jo e vonuar	OK (paguar me 15 shku. 2018)	
Lojtari c	10.08.17	klub Y	100	-	10	120	120	10.09.17	-	-	-	-	-	Paguar plotësisht	OK	
Lojtari d	20.08.17	klub z	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	Kosto free	OK	
Totali						570	220		300							

Shënim 1

Shënim 2

Konfirmojmë plotësimin dhe saktësinë e informacionit të dhënë në këtë tabelë

(Emri i klubit)

Data, emri dhe firma e përfaqësuesit të klubit

Shënim 1

Shënim 2 Duhet të shoqërohet me faqen e bilancit.



FEDERATA
SHQIPTARE E
FUTBOLLIT

T: +355 42 346 601

F: +355 42 346 609

E: info@fshf.al

W: www.fshf.org

A: Rr. "Elbasanit", nr.9, Tirana, Albania